

VENDIM
Nr. 592, datë 18.10.2017

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 955, DATË 7.12.2016, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE, DOKUMENTACIONIT
DHE MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS EKONOMIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pikat 1 e 6, 20, pika 2, dhe 43, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 955, datë 7.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pika 3, e kreut II, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Anëtarët madhorë të familjes paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike.”.

2. Në pikën 9 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

a) Në shkronjën “a”, pas fjalëve “... kryen ndarje të qëllimshme të anëtarëve të familjes ...” shtohen “... që jetojnë në të njëjtën strehë ...”.

b) Në shkronjën “b”, fjalët “... brenda një afati 10-ditor ...” zëvendësohen me “... brenda 10 (dhjetë) ditëve pune ...”.

c) Shkronja “e” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“e) Anëtarët në moshë aktive pune të aftë për punë që nuk rezultojnë punëkërkues të papunë pranë zyrave të punës apo të vetëpunësuar pranë strukturave të tatimeve, me përjashtim të rasteve të familjeve që zotërojnë tokë bujqësore në pronësi/ përdorim.”.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi në datën 1 janar 2018.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi